



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Ekonomisë, Financës, Buxhetit dhe Tatim Taksave

Komisioni Juridik dhe i Administrimit

Raport vendimmarrjeje

Nr 1 /Datë 27.08 2026

"PËR MIRATIMIN E KALIMIT NE PRONËSI TE BASHKISE KOLONJE TE PASURIVE TE PALUAJTSHME"

Analiza ligjore:

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nënpika 1.1, shkronja "a" "c", nenin 23, pika 11, nenin 54, nenin 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" të ndryshuar; ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar; ligjin nr. 20, datë 5.3.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.8.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.1.2023, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 7.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale"; udhëzimin nr. 15, datë 30.6.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimin "Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", si dhe në mbështetje të relacionit të përgatitur nga Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

Situata aktuale e funksionit:

Të miratojë kalimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë të pasurive:

- nr. 266/2, ZK 1594 (Ersekë) me sipërfaqe (sipas LN) 5402 m²
- nr. 264/12, ZK 1594 (Ersekë) me sipërfaqe (sipas LN) 64281 m²
- nr. 443, ZK 1594 (Ersekë) me sipërfaqe (sipas LN) 20267 m²
- nr. 84, ZK 1594 (Ersekë) me sipërfaqe (sipas LN) 22545 m²
- nr. 344/5, ZK 3066 (Psar) me sipërfaqe (sipas LN) 12891 m²
- nr. 283/6, ZK 3556 (Taç Poshtë) me sipërfaqe (sipas LN) 5024 m²

Situata financiare:

Sipas projekt vendimit dhe relacionit qe e shoqeron projekt vendimin.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Administrata e Bashkisë Kolonjë

Monitorimi dhe raportimi:

Keshilli I Bashkise Kolonje

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetare te bashkise Konje

A është objekt i konsultimit publik?Jo

Komisioni i Ekonomisë, Financës,Buxhetit dhe Tatim Taksave


Komisioni Juridik dhe i Administrimit, i mbledhur më datë 27.08 2026, shqyrtoi projektvendimin

"PËR MIRATIMIN E KALIMIT NE PRONËSI TE BASHKISE KOLONJE TE PASURIVE TE PALUAJTSHME". Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit te projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Alma Zeneli  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma) **Sekretar i komisionit**

Datë: 27.08. 2026